<p>2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Departamentit për Diplomaci Ekonomike janë:</p> <p>2.1. Koordinon bashkëpunimin e institucioneve të vendit me institucionet ekonomiko-financiare ndërkombëtare;</p> <p>2.2. Bashkëpunon me ministritë e linjës, sidomos me njësitë përkatëse të integritit, për hartimin dhe analizimin e çështjeve të doganave, tregjeve, bankave dhe sektorëve të tjerë ekonomikë;</p> <p>2.3. Orienton politikat e masat ligjore dhe zbatuese në përputhje me dokumentet strategjike për bashkëpunim ndërkombëtar, përkatësisht procesin e integritimeve ekonomike të Kosovës në institucione ndërkombëtare me karakter ekonomik;</p> <p>2.4. Krijon partneritet të qëndrueshëm me investitorët dhe një klimë nxitëse për zbatimin e politikave të investimeve; bën promovimin e mundësisë së investimeve në Kosovë në bashkëpunim me institucionet relevante dhe misionet diplomatike;</p> <p>2.5. Përforcon dhe mirëmban lidhjet me investitorët, shoqatat e bizneseve dhe bizneset në diasporë, si dhe promovon mundësinë e investimeve në vend;</p>	<p>2. Duties and responsibilities of the Department of Economic Diplomacy shall be as follows:</p> <p>2.1. Coordinate the cooperation of the country's institutions with international economic and financial institutions;</p> <p>2.2. Cooperate with line ministries, especially relevant integration units, for drafting and analysing issues of customs, markets, banks and other economic sectors;</p> <p>2.3. Orient policies and legal and implementing measures in accordance with strategic documents for international cooperation, namely the process of economic integration of Kosovo in international institutions of economic character;</p> <p>2.4. Establish sustainable partnerships with investors and an incentive climate for implementation of investment policies; promote investment opportunities in Kosovo in cooperation with relevant institutions and diplomatic missions;</p> <p>2.5. Strengthen and maintain links with investors, business associations and businesses in the diaspora, and promote investment opportunities in the country;</p>	<p>2. Dužnosti i odgovornosti Odeljenja za ekonomsku diplomatiju:</p> <p>2.1. Koordinira saradnju institucija zemlje sa međunarodnim ekonomskim i finansijskim institucijama;</p> <p>2.2. Sarađuje sa resornim ministarstvima, posebno sa relevantnim jedinicama za integraciju, na izradi i analizi pitanja carina, tržišta, banaka i drugih ekonomskih sektora;</p> <p>2.3. Usmerava politike i zakonske i sprovodilačke mere u skladu sa strateškim dokumentima za međunarodnu saradnju, odnosno proces ekonomske integracije Kosova u međunarodne institucije ekonomskog karaktera;</p> <p>2.4. Stvara održiva partnerstva sa investitorima i podsticajnu klimu za sprovođenje investicionih politika; promovise investicione mogućnosti na Kosovu u saradnji sa relevantnim institucijama i diplomatskim misijama;</p> <p>2.5. Ojačava i održava veze sa investitorima, poslovnim udruženjima i preduzećima u dijaspori, kao i</p>
--	--	---

<p>2.6. Propozon marrëveshje bilaterale dhe memorandumë të bashkëpunimit ekonomik, të cilat kanë për qëllim promovimin e eksportit; promovon produktet e vendit në tregjet rajonale dhe ndërkombëtare, në bashkëpunim me misionet diplomatike të Republikës së Kosovës.</p> <p>3. Drejtori i Departamentit për Diplomaci Ekonomike raporton te Sekretari i Përgjithshëm.</p> <p>4. Në kuadër të këtij departamenti bëjnë pjesë këto divizione:</p> <p>4.1. Divizioni për Promovim dhe Përkrahje të Investimeve, dhe</p> <p>4.2. Divizioni për Bashkëpunim Ekonomik Ndërkombëtar.</p> <p>5. Numri i të punësuarve në Departamentin për Diplomaci Ekonomike është shtatë (7).</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 28</b> <b>Divizioni për Promovim dhe Përkrahje të Investimeve</b></p> <p>1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Promovim dhe Përkrahje të Investimeve janë:</p>	<p>2.6. Propose bilateral agreements and memorandums of economic cooperation, which are aimed at promoting exports; promote domestic products in regional and international markets, in cooperation with the diplomatic missions of the Republic of Kosovo.</p> <p>3. Director of the Department of Economic Diplomacy shall report to the Secretary General.</p> <p>4. The following divisions shall be part of this Department:</p> <p>4.1. Division for Investment Promotion and Support,</p> <p>4.2. Division for International Economic Cooperation.</p> <p>5. Number of employees in the Department of Economic Diplomacy shall be seven (7).</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 28</b> <b>Division for Investment Promotion and Support</b></p> <p>1. Duties and responsibilities of the Division for Investment Promotion and Support shall be as follows:</p>	<p>promoviše mogućnosti ulaganja u zemlji;</p> <p>2.6. Predlaže bilateralne sporazume i memorandumë o ekonomskoj saradnji, koji imaju za cilj unapređenje izvoza; promoviše domaće proizvode na regionalnom i međunarodnom tržištu, u saradnji sa diplomatskim misijama Republike Kosovo.</p> <p>3. Direktor Odeljenja za ekonomsku diplomatiju izveštava generalnom sekretaru.</p> <p>4. U okviru ovog odeljenja nalaze se sledeći odseci:</p> <p>4.1. Odsek za promociju i podršku investicija, i</p> <p>4.2. Odsek za međunarodnu ekonomsku saradnju.</p> <p>5. Broj zaposlenih u Odeljenju za ekonomsku diplomatiju je sedam (7)</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 28</b> <b>Odsek za promociju i podršku investicija</b></p> <p>1. Dužnosti i odgovornosti Odseka za promociju i podršku investicija:</p>
---	---	---



<p>1.1. Në bashkëpunim me institucione të tjera, organizon konferenca, forume dhe takime të ndryshme me investitorët potencialë për nxitjen dhe promovimin e investimeve në Republikën e Kosovës;</p> <p>1.2. Ndhomon vënien e lidhjeve me institucionet relevante vendëse dhe ndërkombëtare, të cilat merren me investime të huaja në Kosovë;</p> <p>1.3. Bashkëpunon me përfaqësues të drejtorive komunale dhe me Asociacionin e Komunave të Kosovës lidhur me promovimin e resurseve, potencialeve dhe mundësive që i posedojnë komunat për të investuar;</p> <p>1.4. Në koordinim me Departamentin për Diplomaci Publike dhe Divizionin për Komunikim me Publikun, bashkëpunon me mediet në Kosovë dhe diasporë për organizimin e emisioneve speciale televizive dhe publikimeve, si emisione storie suksesi të bizneseve, në diasporë dhe veçanërisht me bizneset nga diaspora që kanë investuar në Kosovë;</p> <p>1.5. Përgatit materiale dhe publikime të nevojshme për nxitjen e investimeve në koordinim me Departamentin për Diplomaci Publike;</p>	<p>1.1. In cooperation with other institutions, organize conferences, forums and various meetings with potential investors to encourage and promote investments in the Republic of Kosovo;</p> <p>1.2. Assist in establishing links with relevant local and international institutions dealing with foreign investment in Kosovo;</p> <p>1.3. Collaborate with representatives of municipal directorates and the Association of Kosovo Municipalities regarding the promotion of resources, potentials and opportunities that municipalities possess to invest;</p> <p>1.4. In coordination with the Department of Public Diplomacy and the Division for Public Communication, cooperate with the media in Kosovo and the Diaspora to organize special TV shows and publications, such as business success stories in Diaspora, particularly with businesses from the Diaspora that have invested in Kosovo;</p> <p>1.5. Prepare materials and publications necessary for investment promotion in coordination with the Department of Public Diplomacy;</p>	<p>1.1. U saradnji sa drugim institucijama, organizuje konferencije, forume i razne sastanke sa potencijalnim investitorima za podsticanje i promovisanje investicija u Republici Kosovo;</p> <p>1.2. Pomaže u uspostavljanju veza sa relevantnim lokalnim i međunarodnim institucijama koje se bave stranim investicijama na Kosovu;</p> <p>1.3. Sarađuje sa predstavnicima opštinskih direkcija i Asocijacije Kosovskih Opština u vezi promocije resursa, potencijala i mogućnosti koje opštine poseduju za investiranje;</p> <p>1.4. U koordinaciji sa Odeljenjem za javnu diplomatiju i Odsekom za komunikaciju s javnošću, sarađuje sa medijima na Kosovu i u dijaspori na organizovanju posebnih TV emisija i publikacija, kao što su emisije o uspešnim pričama poslovanja u dijaspori i posebno sa preduzećima iz dijaspore koja su investirala na Kosovu.</p> <p>1.5. Priprema materijale i publikacije potrebne za podsticanje investicija u koordinaciji sa Odeljenjem za javnu diplomatiju;</p>
---	---	---

<p>1.6. Përmes misioneve diplomatike promovon mundësitë ekonomike, potencialet dhe burimet natyrore dhe shërbimet njerëzore të Kosovës në vendet pritëse;</p> <p>1.7. Ndihmon në krijimin dhe mbajtjen e kontakteve me afaristët dhe me bizneset në diasporë;</p> <p>1.8. Harton dhe mirëmban listën e bizneseve të diasporës që kanë investuar në Kosovë;</p> <p>1.9. Mbështet hartimin e strategjive afatmesme dhe afatgjata për tërheqjen e investimeve të huaja;</p> <p>1.10. Merr pjesë në panairë, forume, konferenca, seminare brenda dhe jashtë Kosovës, me të gjithë aktorët e tjerë shtetëror dhe privat, në kuadër të promovimit të resurseve të Kosovës dhe eksportin e prodhimeve të vendit;</p> <p>1.11. Në bashkëpunim me Departamentin për Diplomaci Publike, promovon prodhimet e vendit përmes dërgimit të produkteve të ndryshme konsumuese (pije, ushqime, etj.) dhe jokonsumuese (punime tradicionale, veshje, produkte filigrani, etj.) misioneve diplomatike të Republikës së Kosovës për t'u përdorur gjatë aktiviteteve të misioneve dhe si dhurata</p>	<p>1.6. Through diplomatic missions promote the economic opportunities, potentials and natural resources and human services of Kosovo in the host countries;</p> <p>1.7. Assist in establishing and maintaining contacts with businessmen and businesses in the diaspora;</p> <p>1.8. Draft and maintain the list of diaspora businesses that have invested in Kosovo;</p> <p>1.9. Support development of medium and long-term strategies for attracting foreign investment;</p> <p>1.10. Participate in fairs, forums, conferences, seminars within Kosovo and abroad, with all other state and private stakeholders, in the framework of promoting Kosovo resources and exporting domestic products;</p> <p>1.11. In cooperation with the Department of Public Diplomacy, promote local products by sending various consumer products (beverages, food, etc.) and non-consumer (traditional works, clothing, filigree products, etc.) to the diplomatic missions of the Republic of Kosovo to be used during mission activities and as diplomatic/protocol gifts.</p>	<p>1.6. Preko diplomatskih misija promovise ekonomske mogućnosti, potencijale i prirodne i ljudske resurse Kosova u zemljama prijema;</p> <p>1.7. Pomaže u uspostavljanju i održavanju kontakata sa privrednicima i preduzećima u dijaspori;</p> <p>1.8. Sastavlja i održava listu preduzeća iz dijaspore koja su investirala na Kosovu;</p> <p>1.9. Podržava izradu srednjoročnih i dugoročnih strategija za privlačenje stranih investicija;</p> <p>1.10. Učestvuje na sajmovima, forumima, konferencijama, seminarima unutar i van Kosova, sa svim ostalim državnim i privatnim akterima, u okviru promocije kosovskih resursa i izvoza domaćih proizvoda;</p> <p>1.11. U saradnji sa Odeljenjem za javnu diplomatiju, promovise lokalne proizvode slanjem raznih prehrambenih (pića, hrana, itd.) i neprehrambenih proizvoda (tradicionalni radovi, odeća, filigranski proizvodi itd.) diplomatskim predstavništvima Republike Kosovo radi njihovog korišćenja tokom aktivnosti misije i kao diplomatski/protokolarni pokloni.</p>
--	---	--

<p>diplomatike/protokollare.</p> <p>2. Udhëheqësi i Divizionit për Promovim dhe Përkrahje të Investimeve raporton te drejtori i Departamentit për Diplomaci Ekonomike.</p> <p>3. Numri i të punësuarve në Divizionin për Promovim dhe Përkrahje të Investimeve është tre (3).</p>	<p>2. The head of the Division for Investment Promotion and Support shall report to the director of the Department of Economic Diplomacy.</p> <p>3. The number of employees in the Division for Investment Promotion and Support shall be three (3).</p>	<p>2. Rukovodilac Odseka za promociju i podršku investicija odgovara direktoru Odeljenja za ekonomsku diplomatiju.</p> <p>3. Broj zaposlenih u Odseku za promociju i podršku investicija je tri (3).</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 29</b> <b>Divizioni për Bashkëpunim Ekonomik Ndërkombëtar</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 29</b> <b>Division for International Economic Cooperation</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 29</b> <b>Odsek za međunarodnu ekonomsku saradnju</b></p>
<p>1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Bashkëpunim Ekonomik Ndërkombëtar janë:</p> <p>1.1. Nxiti dhe promovon bashkëpunimin tregtar me vendet e rajonit dhe ato ndërkombëtare;</p> <p>1.2. Në bashkëpunim me misionet diplomatike, mbikëqyr aktivitetin ekonomik me vendet e tjera dhe adreson çdo pengesë potenciale te ministritë dhe institucionet e linjës lidhur me eksportin dhe importin në Kosovë;</p> <p>1.3. Hulumton procedurat e anëtarësimit në institucionet ndërkombëtare me karakter ekonomik/financiar dhe përcjell rrjedhat pas aderimit në këto institucione;</p>	<p>1. Duties and responsibilities of the Division for International Economic Cooperation shall be as follows:</p> <p>1.1. Encourage and promote trade cooperation with countries in the region and internationally;</p> <p>1.2. In cooperation with diplomatic missions, oversee economic activity with other countries and address any potential obstacles to line ministries and institutions with regard to exports and imports to Kosovo;</p> <p>1.3. Research membership procedures in international institutions of economic/financial character and follow the flows after joining these institutions;</p>	<p>1. Dužnosti i odgovornosti Odseka za međunarodnu ekonomsku saradnju:</p> <p>1.1. Podstiče i promoviše trgovinsku saradnju sa zemljama u regionu i na međunarodnom nivou;</p> <p>1.2. U saradnji sa diplomatskim misijama, nadgleda ekonomske aktivnosti sa drugim zemljama i rešava sve potencijalne prepreke resornim ministarstvima i institucijama u vezi sa izvozom i uvozom na Kosovo;</p> <p>1.3. Istražuje procedure članstva u međunarodnim institucijama ekonomskog/finansijskog karaktera i prati tokove nakon pristupanja ovim institucijama;</p>

<p>1.4. Ndjek ecurinë dhe bën vlerësim sistematik të bashkëpunimit ekonomik tregtar të Republikës së Kosovës në aspektin bilateral dhe multilateral;</p> <p>1.5. Propozon memorandume dhe marrëveshje bilaterale për eksportin, si dhe propozon memorandume bashkëpunimi ekonomik me klube të biznesit vendës dhe ndërkombëtar;</p> <p>1.6. Mbështet depërtimin e produkteve të vendit në tregjet rajonale dhe ato ndërkombëtare, në bashkëpunim me misionet diplomatike të Republikës së Kosovës.</p> <p>2. Udhëheqësi i Divizionit për Bashkëpunim Ekonomik Ndërkombëtar raporton te drejtori i Departamentit për Diplomaci Ekonomike.</p> <p>3. Numri i të punësuarve në Divizionin për Bashkëpunim Ekonomik Ndërkombëtar është tre (3).</p>	<p>1.4. Follow the progress and make a systematic assessment of economic and trade cooperation of the Republic of Kosovo in a bilateral and multilateral aspect;</p> <p>1.5. Propose memorandums and bilateral export agreements, and propose memorandum of economic cooperation with domestic and international business clubs;</p> <p>1.6. Support penetration of domestic products in regional and international markets, in cooperation with the diplomatic missions of the Republic of Kosovo.</p> <p>2. Head of the Division for International Economic Cooperation shall report to the Director of the Department of Economic Diplomacy.</p> <p>3. The number of employees in the Division for International Economic Cooperation shall be three (3).</p>	<p>1.4. Prati napredak i vrši sistematsku procenu ekonomske i trgovinske saradnje Republike Kosovo u bilateralnom i multilateralnom aspektu;</p> <p>1.5. Predlaže memorandume i bilateralne sporazume o izvozu, kao i memorandume o ekonomskoj saradnji sa domaćim i međunarodnim poslovnim klubovima;</p> <p>1.6. Podržava prodor domaćih proizvoda na regionalna i međunarodna tržišta, u saradnji sa diplomatskim misijama Republike Kosovo.</p> <p>2. Rukovodilac Odseka za međunarodnu ekonomsku saradnju izveštava direktoru Odeljenja za ekonomsku diplomatiju.</p> <p>3. Broj zaposlenih u Odseku za međunarodnu ekonomsku saradnju je tri (3).</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 30</b> <b>Departamenti për Diplomaci Publike</b></p> <p>1. Misioni i Departamentit për Diplomaci Publike është fuqizimi i imazhit, ndikimit dhe reputacionit të Republikës së Kosovës me një qasje pro-aktive, duke promovuar</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 30</b> <b>Department of Public Diplomacy</b></p> <p>1. The mission of the Department of Public Diplomacy shall be to strengthen the image, influence and reputation of the Republic of Kosovo with a pro-active approach,</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 30</b> <b>Odeljenje za javnu diplomatiju</b></p> <p>1. Misija Odeljenja za javnu diplomatiju je jačanje imidža, uticaja i reputacije Republike Kosovo proaktivnim pristupom, promovišući viziju političke agende koja</p>

<p>një vizion për agjendë politike që i reflekton interesat shtetërore. Departamenti për Diplomaci Publike do të punojë për krijimin dhe promovimin e një “brendi shtetëror” unik të Republikës së Kosovës.</p> <p>2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Departamentit për Diplomaci Publike janë:</p> <p>2.1. Promovimi i imazhit të Republikës së Kosovës jashtë vendit, duke angazhuar palë të ndryshme të interesit (shoqëri civile, media, sektorin privat, akademinë, bashkësinë ndërkombëtare, etj.) përmes publikimeve, ngjarjeve, përdorimit të medie sociale, etj.;</p> <p>2.2. Angazhimi aktiv i opinionit publik ndërkombëtar në avancimin e objektivave të politikës së jashtme të Republikës së Kosovës dhe artikulimi i politikave e pozicioneve të qeverisë në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar, me qëllim të mbrojtjes, promovimit dhe projektimit të imazhit të vendit;</p> <p>2.3. Ngritja e vizibilitetit të aktiviteteve të politikës së jashtme të Republikës së Kosovës përmes përdorimit të mjeteve të reja të komunikimit;</p> <p>2.4. Forcimi i koordinimit dhe ndërveprimit me Shoqatat e Miqësisë dhe</p>	<p>promoting a vision for a political agenda that reflects state interests. Department of Public Diplomacy shall work to establish and promote a unique “state brand” of the Republic of Kosovo.</p> <p>2. Duties and responsibilities of the Department of Public Diplomacy shall be as follows:</p> <p>2.1. Promote the image of the Republic of Kosovo abroad, by engaging various stakeholders (civil society, media, private sector, academia, international community, etc.) through publications, events, use of social media, etc.;</p> <p>2.2. Active engagement of the international public opinion in advancing foreign policy objectives of the Republic of Kosovo and articulating policies and positions of the government at national, regional and international level, in order to protect, promote and project the image of the country;</p> <p>2.3. Increase visibility of foreign policy activities of the Republic of Kosovo by using new means of communication;</p> <p>2.4. Strengthen coordination and interaction with Friendship Associations</p>	<p>odražava državne interese. Odeljenje za javnu diplomatiju će raditi na stvaranju i promovisanju jedinstvenog “državnog brenda” Republike Kosovo.</p> <p>2. Dužnosti i odgovornosti Odeljenja za javnu diplomatiju:</p> <p>2.1. Promovisanje imidža Republike Kosovo u inostranstvu, angažovanjem različitih aktera (civilno društvo, mediji, privatni sektor, akademska zajednica, međunarodna zajednica itd.) kroz publikacije, događaje, korišćenje društvenih medija itd.;</p> <p>2.2. Aktivno angažovanje međunarodnog javnog mnjenja u unapređenju spoljnopolitičkih ciljeva Republike Kosovo i artikulisanoj politici i poziciji vlade na nacionalnom, regionalnom i međunarodnom nivou, u cilju zaštite, promocije i projektovanja imidža zemlje;</p> <p>2.3. Povećanje vidljivosti spoljnopolitičkih aktivnosti Republike Kosovo korišćenjem novih sredstava komunikacije;</p> <p>2.4. Jačanje koordinacije i interakcije sa udruženjima prijateljstva i počasnim</p>
--	---	--

<p>Konsujt e Nderit, me qëllim të promovimit sa më të gjerë të Republikës së Kosovës;</p> <p>2.5. Formulimi i rekomandimeve dhe i strategjive për fuqizimin e imazhit të Republikës së Kosovës në arenën ndërkombëtare;</p> <p>2.6. Promovimi i shkëmbimeve kulturore dhe edukative, të cilat ofrojnë njohuri dhe mirëkuptim më të madh, si dhe nxitin vullnetin e mirë ndërkombëtar;</p> <p>2.7. Mbështetja e departamenteve të MPJD-së dhe misioneve diplomatike të Republikës së Kosovës për ngritjen e imazhit të Republikës së Kosovës përmes diplomacisë publike, digjitale, kulturore dhe sportive;</p> <p>2.8. Përcjellja e zhvillimeve të politikave të jashtme dhe të politikave ekonomike, shoqërore dhe kulturore në vend, që kanë ndikim në imazhin dhe reputacionin e Republikës së Kosovës jashtë vendit;</p> <p>2.9. Zbatimi i diplomacisë publike të Republikës së Kosovës në bashkëpunim me departamentet e tjera të Ministrisë, misionet diplomatike dhe ministritë e tjera të linjës.</p> <p>3. Drejtori i Departamentit për Diplomaci Publike raporton te Sekretari i</p>	<p>and Honorary Consuls, in order to promote the Republic of Kosovo as widely as possible;</p> <p>2.5. Formulate recommendations and strategies for strengthening the image of the Republic of Kosovo in the international arena;</p> <p>2.6. Promote cultural and educational exchanges, which provide greater knowledge and understanding, and foster international goodwill;</p> <p>2.7. Support MFAD's departments and the diplomatic missions of the Republic of Kosovo to improve the image of the Republic of Kosovo through public, digital, cultural and sports diplomacy;</p> <p>2.8. Monitor developments of foreign policy and economic, social and cultural policies in the country, which have an impact on the image and reputation of the Republic of Kosovo abroad;</p> <p>2.9. Implement public diplomacy of the Republic of Kosovo in cooperation with other departments of the Ministry, diplomatic missions and other line ministries.</p> <p>3. Director of the Department of Public Diplomacy shall report to the Secretary</p>	<p>konzulima, u cilju što šire promocije Republike Kosovo;</p> <p>2.5. Formulisanje preporuka i strategija za jačanje imidža Republike Kosovo na međunarodnoj sceni;</p> <p>2.6. Promovisanje kulturne i obrazovne razmene, koje pružaju veće znanje i razumevanje, kao i neguju međunarodnu dobru volju;</p> <p>2.7. Podrška odeljenjima MIPD-a i diplomatskim misijama Republike Kosovo u podizanju imidža Republike Kosovo kroz javnu, digitalnu, kulturnu i sportsku diplomatiju;</p> <p>2.8. Praćenje razvoja spoljne politike i ekonomske, socijalne i kulturne politike u zemlji, koje utiču na imidž i ugled Republike Kosovo u inostranstvu;</p> <p>2.9. Sprovođenje javne diplomatije Republike Kosovo u saradnji sa drugim odeljenjima Ministarstva, diplomatskim misijama i drugim resornim ministarstvima.</p> <p>3. Direktor Odeljenja za javnu diplomatiju izveštava generalnom sekretaru.</p>
--	--	---

<p>Përgjithshëm.</p> <p>4. Në kuadër të këtij departamenti bëjnë pjesë këto divizione:</p> <p>4.1. Divizioni për Diplomaci Publike dhe Digjitale, dhe</p> <p>4.2. Divizioni për Diplomaci Kulturore dhe Sportive.</p> <p>5. Numri i të punësuarve në Departamentin për Diplomaci Publike është shtatë (7).</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 31</b> <b>Divizioni për Diplomaci Publike dhe Digjitale</b></p> <p>1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për diplomaci digjitale janë:</p> <p>1.1. Planifikon, koordinon dhe zbaton komunikimin e Republikës së Kosovës me publikun ndërkombëtar në lidhje me temat e politikës së jashtme;</p> <p>1.2. Krijon brendin/identitetin e MPJD-së dhe sigurohet që komunikimi me publikun ndërkombëtar të bëhet në frymë të njëjtë;</p> <p>1.3. Prodhon materiale (publikime për shtyp, digjitale, audiovizuele, etj.) që e</p>	<p>General.</p> <p>4. The following divisions shall be part of this Department:</p> <p>4.1. Division for Public and Digital Diplomacy,</p> <p>4.2. Division for Cultural and Sports Diplomacy.</p> <p>5. The number of employees in the Department of Public Diplomacy shall be seven (7).</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 31</b> <b>Division for Public and Digital Diplomacy</b></p> <p>1. Duties and responsibilities of the Division for Digital Diplomacy shall be as follows:</p> <p>1.1. Plan, coordinate and implement the communication of the Republic of Kosovo with the international public regarding foreign policy topics;</p> <p>1.2. Establish the brand/identity of MFAD and ensure that communication with international public is done in the same spirit;</p> <p>1.3. Produce materials (print, digital, audio-visual publications, etc.) that</p>	<p>4. U okviru ovog odeljenja nalaze se sledeći odseci:</p> <p>4.1. Odsek za javnu i digitalnu diplomatiju, i</p> <p>4.2. Odsek za kulturnu i sportsku diplomatiju.</p> <p>5. Broj zaposlenih u Odeljenju za javnu diplomatiju je sedam (7).</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 31</b> <b>Odsek za javnu i digitalnu diplomatiju</b></p> <p>1. Dužnosti i odgovornosti Odseka za digitalnu diplomatiju:</p> <p>1.1. Planira, koordinira i sprovodi komunikaciju Republike Kosovo sa međunarodnom javnošću o temama spoljne politike;</p> <p>1.2. Kreira brend/identitet MIPD-a i osigurava da se komunikacija sa međunarodnom javnošću odvija u istom duhu;</p> <p>1.3. Proizvodi materijale (štampane, digitalne, audio-vizuelne publikacije</p>
--	---	---

<p>fuqizojnë imazhin e Republikës së Kosovës, në bashkëpunim me departamente dhe divizione përkatëse të MPJD-së, dhe planifikon fushata të diplomacisë publike për çështje të caktuara sipas nevojës;</p> <p>1.4. Përpilon dhe zbaton propozimet për përdorimin e teknologjisë digjitale dhe mjeteve të reja të komunikimit, në mënyrë që t'i promovojë prioritetet dhe aktivitetet kryesore të politikës së jashtme të Republikës së Kosovës;</p> <p>1.5. Krijon dhe mban kontakte me medie dhe me gazetarë ndërkombëtare në mbështetje të komunikimit të objektivave kryesore të politikës së jashtme të Republikës së Kosovës, si dhe organizon rregullisht vizita të gazetarëve të huaj në Kosovë, për të ofruar një kuptim më të mirë dhe paraqitje sa më pozitive të vendit në arenën ndërkombëtare;</p> <p>1.6. Ofron mbështetje për misionet diplomatike të Republikës së Kosovës për prodhimin e materialeve të ndryshme (publikime, shkrime në medie, materiale digjitale), si dhe përdor mjete digjitale të komunikimit për një menaxhim sa më proaktiv të imazhit pozitiv të Kosovës;</p> <p>1.7. Përpilon dhe siguron zbatimin e një</p>	<p>enhance the image of the Republic of Kosovo, in cooperation with relevant departments and divisions of the MFA, and plan public diplomacy campaigns on certain issues as needed;</p> <p>1.4. Draft and implement proposals for the use of digital technology and new means of communication, in order to promote main foreign policy priorities and activities of the Republic of Kosovo;</p> <p>1.5. Establish and maintain contacts with the media and international journalists in support of communication of main objectives of the foreign policy of the Republic of Kosovo, and regularly organize visits of foreign journalists to Kosovo, to provide a better understanding and positive presentation of the country in the international arena;</p> <p>1.6. Provide support to the diplomatic missions of the Republic of Kosovo for the production of various materials (publications, media articles, digital materials), as well as use digital communication tools for a more proactive management of the positive image of Kosovo;</p> <p>1.7. Develop and ensure the</p>	<p>itd.) koji jačaju imidž Republike Kosovo, u saradnji sa relevantnim odeljenjima i odsecima MIPD-a, i planira kampanje javne diplomatije o određenim pitanjima po potrebi;</p> <p>1.4. Sastavlja i sprovodi predloge za korišćenje digitalne tehnologije i novih sredstava komunikacije, u cilju promovisanja glavnih prioriteta i aktivnosti spoljne politike Republike Kosovo;</p> <p>1.5. Uspostavlja i održava kontakte sa medijima i međunarodnim novinarima kao podrška saopštavanju glavnih ciljeva spoljne politike Republike Kosovo, kao i redovno organizuje posete stranih novinara Kosovu, radi boljeg razumevanja i što pozitivnijeg predstavljanja zemlje na međunarodnoj sceni;</p> <p>1.6. Pruža podršku diplomatskim misijama Republike Kosovo za proizvodnju različitih materijala (publikacije, medijski članci, digitalni materijali), kao i koristi sredstva za digitalnu komunikaciju za proaktivnije upravljanje pozitivnim imidžom Kosova;</p> <p>1.7. Razvija i obezbeđuje sprovođenje</p>
---	---	---



<p>udhëzuesi për përdorimin e medieve sociale si mjete të diplomacisë publike;</p> <p>1.8. Bashkëpunon me Akademinë Diplomatike për t'iu ofruar trajnime diplomatëve të Republikës së Kosovës lidhur me përdorimin e mjeteve digjitale të komunikimit për arritjen e objektivave diplomatike.</p> <p>2. Udhëheqësi i Divizionit për Diplomaci Publike dhe Digjitale raporton te drejtori e Departamentit për Diplomaci Publike.</p> <p>3. Numri i të punësuarve në Divizionin për Diplomaci Publike dhe Digjitale është tre (3).</p>	<p>implementation of a guideline for the use of social media as tools of public diplomacy;</p> <p>1.8. Cooperate with the Diplomatic Academy in providing trainings to diplomats of the Republic of Kosovo regarding the use of digital means of communication to achieve diplomatic objectives.</p> <p>2. Head of the Division for Public and Digital Diplomacy shall report to the Director of the Department of Economic Diplomacy.</p> <p>3. The number of employees in the Division for Public and Digital Diplomacy shall be three (3).</p>	<p>smernica za korišćenje društvenih medija kao alata javne diplomatije;</p> <p>1.8. Sarađuje sa Diplomatskom akademijom na obezbeđivanju obuke za diplomate Republike Kosovo u vezi sa korišćenjem sredstava za digitalnu komunikaciju za postizanje diplomatskih ciljeva.</p> <p>2. Rukovodilac Odseka za javnu i digitalnu diplomatiju izveštava direktoru Odeljenja za javnu diplomatiju.</p> <p>3. Broj zaposlenih u Odseku za javnu i digitalnu diplomatiju je tri (3).</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 32</b> <b>Divizioni për Diplomaci Kulture dhe Sportive</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 32</b> <b>Division for Cultural and Sports Diplomacy</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 32</b> <b>Odsek za kulturnu i sportsku diplomatiju</b></p>
<p>1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Diplomaci Kulture dhe Sportive janë:</p> <p>1.1. Zhvillon bashkëpunimin kulturor dhe sportiv ndërkombëtar, me qëllim të promovimit të kulturës dhe të sportit të Republikës së Kosovës jashtë vendit;</p> <p>1.2. Në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS) dhe</p>	<p>1. Duties and responsibilities of the Division for Cultural and Sports Diplomacy shall be as follows:</p> <p>1.1. Develop international cultural and sports cooperation, in order to promote the culture and sports of the Republic of Kosovo abroad;</p> <p>1.2. In cooperation with the Ministry of Culture, Youth and Sports (MCYS) and</p>	<p>1. Dužnosti i odgovornosti Odseka za kulturnu i sportsku diplomatiju:</p> <p>1.1. Razvija međunarodnu kulturnu i sportsku saradnju, u cilju promocije kulture i sporta Republike Kosovo u inostranstvu;</p> <p>1.2. U saradnji sa Ministarstvom kulture, omladine i sporta (MKOS) i</p>

<p>me misione diplomatike, planifikon, koordinon dhe i realizon aktivitetet e politikës së jashtme kulturore dhe sportive të Kosovës;</p> <p>1.3. Mbështet Departamentin e Organizatave Ndërkombëtare gjatë lobimit për anëtarësime në organizata rajonale dhe ndërkombëtare kulturore dhe sportive;</p> <p>1.4. Organizon ngjarje jashtë vendit për promovimin e artistëve kosovarë (ekspozita, shfaqje filmi, promovime librash, etj.), vizita kulturore dhe sportive jashtë vendit, si dhe vizita të artistëve, sportistëve dhe udhëheqësve të industrive kulturore dhe sportive nga jashtë në Republikën e Kosovës;</p> <p>1.5. Në koordinim me departamentet përkatëse në MPJD, misionet diplomatike dhe MKRS-në, propozon marrëveshje për bashkëpunime kulturore dhe sportive bilaterale, për të siguruar shkëmbime të dobishme ose mbështetje për industri të ndryshme (kinematografi, art bashkëkohor, muzikë, sport, etj.);</p> <p>1.6. Promovon dhe lehtëson pjesëmarrjen e artistëve dhe të sportistëve që përfaqësojnë Republikën e Kosovës në festivale dhe gara rajonale e ndërkombëtare;</p>	<p>with diplomatic missions, plan, coordinate and implement the activities of Kosovo's foreign cultural and sports policy;</p> <p>1.3. Support the Department of International Organizations in lobbying for membership in regional and international cultural and sports organizations;</p> <p>1.4. Organize events abroad for the promotion of Kosovar artists (exhibitions, film screenings, book promotions, etc.), cultural and sports visits abroad and visits of artists, athletes and leaders of cultural and sports industries from abroad to the Republic of Kosovo;</p> <p>1.5. In coordination with the relevant departments in MFAD, diplomatic missions and MCYS, proposes agreements for bilateral cultural and sports cooperation, to provide useful exchanges or support for various industries (cinematography, contemporary art, music, sports, etc.);</p> <p>1.6. Promote and facilitate participation of artists and athletes representing the Republic of Kosovo in regional and international festivals and competitions;</p>	<p>diplomatskim misijama, planira, koordinira i sprovodi aktivnosti spoljne kulturne i sportske politike Kosova;</p> <p>1.3. Podržava Odeljenje za međunarodne organizacije u lobiranju za članstvo u regionalnim i međunarodnim kulturnim i sportskim organizacijama;</p> <p>1.4. Organizuje događaje u inostranstvu za promociju kosovskih umetnika (izložbe, filmske projekcije, promocije knjiga itd.), kulturne i sportske posete inostranstvu, kao i posete umetnika, sportista i rukovodioca kulturnih i sportskih industrija iz inostranstva u Republici Kosovo;</p> <p>1.5. U koordinaciji sa relevantnim odeljenjima u MIPD-u, diplomatskim misijama i MKOS-om, predlaže sporazume o bilateralnoj kulturnoj i sportskoj saradnji, radi pružanja korisnih razmena ili podrške različitim industrijama (kinematografija, savremena umetnost, muzika, sport itd.);</p> <p>1.6. Promoviše i omogućava učešće umetnika i sportista koji predstavljaju Republiku Kosovo na regionalnim i međunarodnim festivalima i takmičenjima;</p>
---	--	---

<p>1.7. Përforcon bashkëpunimin me aktorë ndërkombëtarë institucionalë dhe individualë (Ministri të Jashtme, Ambasadorë, Ministri të Kulturës dhe Sportit, media, sektor privat, artistë, sportista) për promovimin e talenteve nga Republika e Kosovës dhe për tërheqjen e mbështetjes ndërkombëtare për iniciativa të ndryshme kulturore dhe sportive në vend;</p> <p>1.8. Bashkëpunon me Divizionin për Diplomaci Publike dhe Digjitale për promovimin e artistëve dhe sportistëve kosovarë në arenën rajonale dhe ndërkombëtare përmes përgatitjes së materialeve të shtypura, digjitale ose audio-vizuele;</p> <p>1.9. Promovon kulturën e Republikës së Kosovës, duke identifikuar vepra të artistëve kosovarë (për blerje apo marrje në huazim), për t'u ekspozuar në ambiente të MPJD-së, misioneve diplomatike dhe rezidencave të shefave të misioneve diplomatike të Republikës së Kosovës.</p> <p>2. Udhëheqësi i Divizionit për Diplomaci Kulturore dhe Sportive raporton te drejtori/ja e Departamentit për Diplomaci Publike.</p>	<p>1.7. Strengthen cooperation with international institutional and individual stakeholders (Ministry of Foreign Affairs, Ambassadors, Ministry of Culture and Sports, media, private sector, artists, athletes) to promote talent from the Republic of Kosovo and attract international support for various cultural initiatives and sports in the country;</p> <p>1.8. Cooperate with the Division for Public and Digital Diplomacy for the promotion of Kosovar artists and athletes in the regional and international arena through the preparation of printed, digital or audio-visual materials;</p> <p>1.9. Promote the culture of the Republic of Kosovo, identifying works by Kosovar artists (for purchase or borrowing) to be displayed in the premises of the MFA, diplomatic missions and residences of the heads of diplomatic missions of the Republic of Kosovo.</p> <p>2. The head of the Division for Cultural and Sports Diplomacy shall report to the Director of the Department of Public Diplomacy.</p>	<p>1.7. Ojaçava saradnju sa međunarodnim institucionalnim i pojedinačnim akterima (Ministarstvima spoljnih poslova, ambasadorima, Ministarstvima kulture i sporta, medijima, privatnim sektorom, umetnicima, sportistima) u cilju promocije talenata iz Republike Kosovo i privlačenja međunarodne podrške za različite kulturne i sportske inicijative u zemlji;</p> <p>1.8. Sarađuje sa Odsekom za javnu i digitalnu diplomatiju za promociju kosovskih umetnika i sportista na regionalnoj i međunarodnoj sceni kroz pripremu štampanih, digitalnih ili audio-vizuelnih materijala;</p> <p>1.9. Promoviše kulturu Republike Kosovo, identifikujući dela kosovskih umetnika (za kupovinu ili pozajmicu), koja će biti izložena u prostorijama MIPD-a, diplomatskim misijama i rezidencijama šefova diplomatskih misija Republike Kosovo.</p> <p>2. Rukovodilac Odseka za kulturnu i sportsku diplomatiju izveštava direktoru Odjeljenja za javnu diplomatiju.</p>
---	---	---

<p>3. Numri i të punësuarve në Divizionin për Diplomaci Kulturore dhe Sportive është tre (3).</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 33</b> <b>Departamenti për Diasporë</b></p> <p>1. Misioni i Departamentit për Diasporë është të kontribuojë për ruajtjen, kultivimin dhe zhvillimin e identitetit gjuhësor, kulturor e arsimor të pjesëtarëve të diasporës, t'i fuqizojë lidhjet me Kosovën dhe t'i promovojë e t'i avancojë të drejtat politike dhe sociale të diasporës.</p> <p>2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Departamentit për Diasporë janë:</p> <p>2.1. Identifikon dhe krijon mënyra të reja të bashkëpunimit mes pjesëtarëve të diasporës dhe institucioneve të Republikës së Kosovës;</p> <p>2.2. Ndhmon krijimin e kushteve për ruajtjen, kultivimin dhe zhvillimin e identitetit gjuhësor e kulturor të diasporës;</p> <p>2.3. Propozon, mbështet dhe organizon projekte arsimore, kulturore dhe sportive për diasporën;</p> <p>2.4. Angazhohet për avancimin e të drejtave politike dhe sociale të diasporës;</p>	<p>3. The number of employees in the Division for Cultural and Sports Diplomacy shall be three (3).</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 33</b> <b>Department of Diaspora</b></p> <p>1. The mission of the Department of Diaspora shall be to contribute to the preservation, cultivation and development of linguistic, cultural and educational identity of members of diaspora; strengthen ties with Kosovo and promote and advance the political and social rights of diaspora.</p> <p>2. Duties and responsibilities of the Department of Diaspora shall be as follows:</p> <p>2.1. Identify and create new ways of cooperation between members of the diaspora and institutions of the Republic of Kosovo;</p> <p>2.2. Help create conditions for the preservation, cultivation and development of linguistic and cultural identity of the diaspora;</p> <p>2.3. Propose, support and organize educational, cultural and sports projects for the diaspora;</p> <p>2.4. Engage for the advancement of political and social rights of the diaspora;</p>	<p>3. Broj zaposlenih u Odseku za kulturnu i sportsku diplomatiju je tri (3).</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 33</b> <b>Odeljenje za dijasporu</b></p> <p>1. Misija Odeljenja za dijasporu je da doprinosi očuvanju, negovanju i razvoju jezičkog, kulturnog i obrazovnog identiteta pripadnika dijaspore; ojača veze sa Kosovom i promoviše i unapredi politička i socijalna prava dijaspore.</p> <p>2. Dužnosti i odgovornosti Odeljenja za dijasporu:</p> <p>2.1. Identifikuje i stvara nove načine saradnje između pripadnika dijaspore i institucija Republike Kosovo;</p> <p>2.2. Pomaže stvaranju uslova za očuvanje, negovanje i razvoj jezičkog i kulturnog identiteta dijaspore;</p> <p>2.3. Predlaže, podržava i organizuje obrazovne, kulturne i sportske projekte za dijasporu;</p> <p>2.4. Zalaže se za unapređenje političkih i socijalnih prava dijaspore;</p>
--	--	---

<p>njësitë apo zyrtarët përgjegjës për hartimin e projektakteve normative, siguron përputhshmërinë e akteve normative të propozuara nga Ministria me legjislacionin e aplikueshëm në Republikën e Kosovës, si dhe legjislacionin e Bashkimit Evropian-Acquis të BE-së, duke përfshirë përgatitjen e Deklaratës së Përputhshmërisë (DeP) dhe Tabelat e Përputhshmërisë (TeP);</p> <p>2.4. Jep opinione ligjore të kërkuara nga fushëveprimi i ministrisë përkatëse;</p> <p>2.5. Siguron respektimin e teknikave dhe standardeve të hartimit të legjislacionit nga fushëveprimi i Ministrisë;</p> <p>2.6. Ofron opinione, këshilla dhe rekomandime ligjore, sipas kërkesës për departamentet dhe njësitë e tjera të Ministrisë;</p> <p>2.7. Bashkëpunon me Zyrën Ligjore të ZKM-së për përgatitjen, monitorimin dhe raportimin e Programit Legjislativ dhe për aktivitete të tjera që ndërlihen me procesin e hartimit të legjislacionit;</p> <p>2.8. Koordinon dhe mbikëqyr procesin e nismave për marrëveshje ndërkombëtare, të iniciuara nga ministritë dhe institucionet e tjera shtetërore. Siguron që procedura të bëhet në pajtim me Ligjin</p>	<p>units or officials responsible for drafting normative draft acts, ensure the compliance of normative acts proposed by the Ministry with the legislation applicable in the Republic of Kosovo, as well as the legislation of the European Union - EU Acquis, including the preparation of Statement of Compliance (SoC) and Tables of Compliance (ToC);</p> <p>2.4. Provide legal opinions required within the scope of the relevant Ministry;</p> <p>2.5. Ensure the observance of techniques and standards of drafting legislation within the scope of the Ministry;</p> <p>2.6. Provide legal opinions, advice and recommendations, upon request, for other departments and units of the Ministry;</p> <p>2.7. Cooperate with the Legal Office of the OPM for the preparation, monitoring and reporting of the Legislative Program and for other activities related to the process of drafting legislation;</p> <p>2.8. Coordinate and supervise the process of initiatives for international agreements, initiated by Ministries and other state institutions. Ensure that the procedure is done in accordance with the</p>	<p>jedinicama ili službenicima odgovornim za izradu nacarta normativnih akata, obezbeđuje usklađenost normativnih akata koje predlaže Ministarstvo sa važećim zakonodavstvom u Republici Kosovo, kao i sa zakonodavstvom Evropske unije – acquis-om EU-a, uključujući pripremu Izjave o usklađenosti (IoU) i Tabele usklađenosti (TU);</p> <p>2.4. Daje tražena pravna mišljenja iz delokruga resornog ministarstva;</p> <p>2.5. Obezbeđuje poštovanje tehnika i standarda izrade propisa iz delokruga Ministarstva;</p> <p>2.6. Daje mišljenja, savete i pravne preporuke, na zahtev drugim odeljenjima i jedinicama Ministarstva;</p> <p>2.7. Sarađuje sa Pravnom kancelarijom KP-a za pripremu, praćenje i izveštavanje o Zakonodavnom programu i za druge aktivnosti u vezi sa procesom izrade zakona;</p> <p>2.8. Koordinira i nadzire proces inicijativa za međunarodne sporazume, koje iniciraju ministarstva i druge državne institucije. Obezbeđuje da se postupak odvija u skladu sa Zakonom o</p>
--	---	--

<p>për Marrëveshjet Ndërkombëtare, si dhe mban evidencën e të gjitha marrëveshjeve ndërkombëtare që lidhen në emër të Shtetit dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës;</p> <p>2.9. Mbikëqyr zbatimin e legjislacionit dhe identifikon probleme të zbatimit të akteve normative;</p> <p>2.10. Bashkëpunon me Ministrinë e Drejtësisë për përfaqësimin e Ministrisë në kontestet gjyqësore;</p> <p>2.11. Koordinon aktivitetet për zbatimin e legjislacionit me njësitë përkatëse të Ministrisë dhe me ministrinë e tjera e Qeverinë;</p> <p>2.12. Mban dhe përditëson regjistrin e akteve nënligjore të Ministrisë;</p> <p>2.13. Dërgon aktet nënligjore në Zyrën Ligjore të Kryeministrit pas miratimit të tyre nga Ministri;</p> <p>2.14. Siguron përmbushjen e detyrave ligjore për zbatimin e ligjit dhe të dispozitave të tjera nga fushëveprimi i Ministrisë;</p> <p>2.15. Harton propozimvendime, propozime të materialeve të ndryshme, të kërkuara nga Sekretari i Përgjithshëm dhe Ministri;</p>	<p>Law on International Agreements, and keep records of all international agreements concluded on behalf of the State and the Government of the Republic of Kosovo;</p> <p>2.9. Oversee the implementation of legislation and identify problems of implementation of normative acts;</p> <p>2.10. Collaborate with the Ministry of Justice for the representation of the Ministry in litigation;</p> <p>2.11. Coordinate activities for implementation of legislation with the respective units of the Ministry and with other Ministries and the Government;</p> <p>2.12. Maintain and update the register of bylaws of the Ministry;</p> <p>2.13. Send the bylaws to the Legal Office of the Office of the Prime Minister after their approval by the Minister;</p> <p>2.14. Ensure the fulfilment of legal duties for implementation of the law and other provisions within the scope of the Ministry;</p> <p>2.15. Compile draft decisions, proposals of various materials, requested by the Secretary General and the Minister;</p>	<p>međunarodnim sporazumima i vodi evidenciju o svim međunarodnim sporazumima zaključenim u ime države i vlade Republike Kosovo;</p> <p>2.9. Nadzire sprovođenje zakonodavstva i identifikuje probleme u sprovođenju normativnih akata;</p> <p>2.10. Sarađuje sa Ministarstvom pravde na zastupanju Ministarstva u sudskim sporovima;</p> <p>2.11. Koordinira aktivnosti za sprovođenje zakona sa odgovarajućim jedinicama Ministarstva i drugim ministarstvima Vlade;</p> <p>2.12. Održava i ažurira registar podzakonskih akata Ministarstva;</p> <p>2.13. Šalje podzakonske akte Pravnoj kancelariji u Kancelarije Premijera nakon što ih odobri ministar;</p> <p>2.14. Brine o izvršavanju zakonskih obaveza za sprovođenje zakona i drugih propisa iz delokruga Ministarstva;</p> <p>2.15. Izrađuje nacрте odluka, predloge različitih materijala na zahtev generalnog sekretara i ministra;</p>
--	--	---

<p>2.16. Ofron asistencë juridike në procesin e negocimit, nënshkrimit, ratifikimit dhe zbatimit të marrëveshjeve ndërkombëtare;</p> <p>2.17. Kryen detyra të tjera të përcaktuara me legjislacionin përkatës.</p> <p>3. Drejtori i Departamentit për Çështje Ligjore dhe Traktate raporton te Sekretari i Përgjithshëm.</p> <p>4. Në kuadër të këtij departamenti bëjnë pjesë këto divizionet:</p> <p>4.1. Divizioni për Hartim dhe Harmonizim të Legjislacionit;</p> <p>4.2. Divizioni për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Ligjeve, Mbështetjes Ligjore dhe Bashkëpunimit Ndërinstitucional në Fushën e Legjislacionit;</p> <p>4.3. Divizioni për Traktate dhe Marrëveshje Ndërkombëtare.</p> <p>5. Numri i të punësuarve në Departamentin për Çështje Ligjore dhe Traktate është njëmbëdhjetë (11).</p>	<p>2.16. Provide legal assistance in the process of negotiating, signing, ratifying and implementing international agreements;</p> <p>2.17. Perform other duties defined by the relevant legislation.</p> <p>3. Director of the Department for Legal Affairs and Treaties shall report to the Secretary General.</p> <p>4. The following Divisions shall be part of this Department:</p> <p>4.1. Division for Drafting and Harmonization of Legislation;</p> <p>4.2. Division for Supervision of Law Enforcement, Legal Support and Inter-Institutional Cooperation in the Field of Legislation;</p> <p>4.3. Division for International Treaties and Agreements.</p> <p>5. Number of employees in the Department of Legal Affairs and Treaties shall be eleven (11).</p>	<p>2.16. Pruža pravnu pomoć u procesu pregovaranja, potpisivanja, ratifikacije i sprovođenja međunarodnih sporazuma;</p> <p>2.17. Obavlja i druge poslove utvrđene relevantnim zakonodavstvom.</p> <p>3. Direktor Odeljenja za pravna pitanja i ugovore odgovara generalnom sekretaru.</p> <p>4. U okviru ovog Odeljenja nalaze se sledeći odseci:</p> <p>4.1. Odsek za izradu i usklađivanje zakonodavstva;</p> <p>4.2. Odsek za nadzor nad sprovođenjem zakona, pravnu podršku i međuinstitucionalnu saradnju u oblasti zakonodavstva;</p> <p>4.3. Odsek za međunarodne ugovore i sporazume.</p> <p>5. Broj zaposlenih u Odeljenju za pravne poslove i ugovore je jedanaest (11).</p>
--	--	---

<p style="text-align: center;"><b>Neni 41</b> <b>Divizioni për Hartim dhe Harmonizim të Legjislacionit</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 41</b> <b>Division for Drafting and Harmonizing Legislation</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 41</b> <b>Odsek za izradu i usklađivanje zakonodavstva</b></p>
<p>1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për hartim dhe harmonizim të legjislacionit:</p> <p>1.1. Ofron ndihmë në hartimin e legjislacionit dhe siguron pajtueshmërinë me Kushtetutën dhe ligjet e aplikueshme në Kosovë;</p> <p>1.2. Ofron ndihmë për strukturat organizative të ministrisë për identifikimin e çështjeve që duhen normuar;</p> <p>1.3. Ofron këshilla, rekomandime dhe opinione ligjore, të kërkuara, për të gjitha strukturat e Ministrisë, përfshirë misionet diplomatike dhe konsullore të Republikës së Kosovës, nga fushëveprimi i Ministrisë;</p> <p>1.4. Siguron harmonizimin e legjislacionit të Ministrisë me <i>acquis communautaire</i> dhe me ligjet e aplikueshme në Kosovë.</p> <p>2. Udhëheqësi i Divizionit për Hartimin dhe Harmonizimin e Legjislacionit raporton te drejtori i Departamentit për Çështje Ligjore</p>	<p>1. Duties and responsibilities of the Division for Drafting and Harmonizing Legislation shall be as follows:</p> <p>1.1. Provide assistance in drafting legislation and ensure compliance with the Constitution and applicable laws in Kosovo;</p> <p>1.2. Provide assistance to organizational structures of the Ministry to identify issues to be addressed;</p> <p>1.3. Provide legal advice, recommendations and opinions required for all structures of the Ministry, including diplomatic and consular missions of the Republic of Kosovo, within the scope of the Ministry;</p> <p>1.4. Ensure harmonization of legislation of the Ministry with the <i>acquis communautaire</i> and with the applicable laws in Kosovo.</p> <p>2. Head of the Division for Drafting and Harmonization of Legislation shall report to the Director of the Department of Legal</p>	<p>1. Dužnosti i odgovornosti Odseka za izradu i usklađivanje zakonodavstva:</p> <p>1.1. Pruža pomoć u izradi nacрта zakona i obezbeđuje usaglašenost sa Ustavom i važećim zakonima na Kosovu;</p> <p>1.2. Pruža pomoć organizacionim strukturama ministarstva za identifikaciju pitanja koja treba normirati;</p> <p>1.3. Daje savete, preporuke i potrebna pravna mišljenja za sve strukture Ministarstva, uključujući diplomatske i konzularne misije Republike Kosovo, iz delokruga Ministarstva;</p> <p>1.4. Obezbeđuje usklađenost zakonodavstva Ministarstva sa <i>acquis communautaire</i> i sa važećim zakonima na Kosovu.</p> <p>2. Rukovodilac Odseka za izradu i usklađivanje zakonodavstva odgovara direktoru Odeljenja za pravne poslove i</p>

<p>dhe Traktate.</p> <p>3. Numri i të punësuarve në Divizionin për Hartimin dhe Harmonizimin e Legjislacionit është katër (4);</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 42</b> <b>Divizioni për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Ligjeve, Mbështetjes Ligjore dhe Bashkëpunimit Ndërinstitucional në Fushën e Legjislacionit</b></p> <p>1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Ligjeve, Mbështetjes Ligjore dhe Bashkëpunimit Ndërinstitucional në Fushën e Legjislacionit:</p> <p>1.1. Koordinon aktivitetet me të gjitha strukturat organizative të Ministrisë për zbatimin e legjislacionit;</p> <p>1.2. Ofron mbështetje ligjore në fushën e legjislacionit;</p> <p>1.3. Bën vlerësimin ex-post të ligjeve dhe akteve nënligjore të hartuara nga Ministria, si dhe rekomandon adresimin e problemeve të identifikuara për zbatimin e akteve normative;</p> <p>1.4. Ofron mbështetje ligjore për hartimin e propozimvendimeve, propozim-marrëveshjeve, propozim-</p>	<p>Affairs and Treaties.</p> <p>3. The number of employees in the Division for Drafting and Harmonization of Legislation shall be four (4);</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 42</b> <b>Division for Supervision of Law Enforcement, Legal Support and Inter-Institutional Cooperation in the Field of Legislation</b></p> <p>1. Duties and responsibilities of the Division for Supervision of Law Enforcement, Legal Support and Inter-Institutional Cooperation in the Field of Legislation shall be as follows:</p> <p>1.1. Coordinate activities with all organizational structures of the Ministry for implementation of legislation;</p> <p>1.2. Provide legal support in the field of legislation;</p> <p>1.3. Conduct ex-post evaluation of laws and bylaws drafted by the Ministry, and recommend addressing identified problems for the implementation of normative acts;</p> <p>1.4. Provide legal support for compiling draft decisions, draft agreements, draft memorandums and draft contracts;</p>	<p>ugovore.</p> <p>3. Broj zaposlenih u Odseku za izradu i usklađivanje zakonodavstva je četiri (4);</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 42</b> <b>Odsek za nadzor nad sprovođenjem zakona, pravnu podršku i međuinstitucionalnu saradnju u oblasti zakonodavstva</b></p> <p>1. Dužnosti i odgovornosti Odseka za nadzor nad sprovođenjem zakona, pravnu podršku i međuinstitucionalnu saradnju u oblasti zakonodavstva:</p> <p>1.1. Koordinira aktivnosti sa svim organizacionim strukturama Ministarstva za sprovođenje zakonodavstva;</p> <p>1.2. Pruža pravnu podršku u oblasti zakonodavstva;</p> <p>1.3. Vršiti Ex-post procenu zakona i podzakonskih akata koje je izradilo Ministarstvo, i preporučuje rešavanje identifikovanih problema za sprovođenje normativnih akata;</p> <p>1.4. Pruža pravnu podršku za izradu predloga odluka, predloga sporazuma, predloga memoranduma i predloga</p>
---	--	--

<p>memorandumeve dhe propozim-kontratave;</p> <p>1.5. Koordinimi i aktiviteteve legislative të Ministrisë me institucionet përkatëse;</p> <p>1.6. Mirëmbajtja e regjistrit të akteve nënligjore të Ministrisë.</p> <p>2. Udhëheqësi i Divizionit për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve, mbështetjes ligjore dhe bashkëpunimit ndërinstitucional në fushën e legjislacionit raporton te drejtori i Departamentit për Çështje Ligjore dhe Traktate.</p> <p>3. Numri i të punësuarve në Divizionin për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Legjislacionit është tre (3).</p>	<p>1.5. Coordinate legislative activities of the Ministry with relevant institutions;</p> <p>1.6. Maintain the register of bylaws of the Ministry.</p> <p>2. Head of the Division for Supervision of Law Enforcement, Legal Support and Inter-Institutional Cooperation in the Field of Legislation shall report to the Director of the Department of Legal Affairs and Treaties.</p> <p>3. The number of employees in the Division for Supervision of Law Enforcement shall be three (3).</p>	<p>ugovora;</p> <p>1.5. Koordinacija zakonodavnih aktivnosti Ministarstva sa nadležnim institucijama;</p> <p>1.6. Vođenje registra podzakonskih akata Ministarstva.</p> <p>2. Rukovodilac Odseka za nadzor nad sprovođenjem zakona, pravnu podršku i međuinstitucionalnu saradnju u oblasti zakonodavstva odgovara direktoru Odeljenja za pravne poslove i ugovore.</p> <p>3. Broj zaposlenih u Odseku za nadzor nad sprovođenjem zakonodavstva je tri (3).</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 43</b> <b>Divizioni për Traktate dhe Marrëveshje Ndërkombëtare</b></p> <p>1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Traktate dhe Marrëveshje Ndërkombëtare:</p> <p>1.1. Ofron këshilla ligjore lidhur me interpretimin e traktateve ose marrëveshjeve ndërkombëtare;</p> <p>1.2. Ofron këshilla ligjore për procedurat që ndërliken me negocimin,</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 43</b> <b>Division for International Treaties and Agreements</b></p> <p>1. Duties and responsibilities of the Division for International Treaties and Agreements shall be as follows:</p> <p>1.1. Provide legal advice regarding the interpretation of international treaties or agreements;</p> <p>1.2. Provide legal advice on procedures related to the negotiation, signing and</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 43</b> <b>Odsek za međunarodne ugovore i sporazume</b></p> <p>1. Dužnosti i odgovornosti Odseka za međunarodne ugovore i sporazume:</p> <p>1.1. Pruža pravne savete u vezi sa tumačenjem međunarodnih ugovora ili sporazuma;</p> <p>1.2. Pruža pravne savete o procedurama u vezi sa pregovaranjem, potpisivanjem</p>



<p>nënshkrimin dhe zbatimin e marrëveshjeve dy apo shumëpalëshe;</p> <p>1.3. Mirëmban bazën e të dhënave me informacionet që ndërlidhen me traktatet dhe marrëveshjet ndërkombëtare;</p> <p>1.4. Mirëmban origjinalin e tekstit të nënshkruar, traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare të lidhura në emër të shtetit dhe Qeverisë së Republikës së Kosovës me autoritetet relevante.</p> <p>2. Udhëheqësi i Divizionit për Traktate dhe Marrëveshje Ndërkombëtare raporton te udhëheqësi i Departamentit për Çështje Ligjore dhe Traktate.</p> <p>3. Numri i të punësuarve në Divizionin për Traktate dhe Marrëveshje Ndërkombëtare është tre (3).</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 44</b> <b>Departamenti për Shërbime të Përgjithshme</b></p> <p>1. Misioni i Departamentit për Shërbime të Përgjithshme është t’u ofrojë punonjësve në MPJD dhe në MDK kushtet fizike të punës, pajisjet e nevojshme dhe shërbimet mbështetëse për kryerjen e detyrave të tyre, si dhe të sigurojë administrimin e mirëfilltë të dokumenteve të brendshme të MPJD-së.</p>	<p>implementation of bilateral or multilateral agreements;</p> <p>1.3. Maintain the database with information related to international treaties and agreements;</p> <p>1.4. Maintain the original of the signed text, treaties and international agreements concluded on behalf of the state and the Government of the Republic of Kosovo with the relevant authorities.</p> <p>2. Head of the Division for International Treaties and Agreements shall report to the Head of the Department for Legal Affairs and Treaties.</p> <p>3. The number of employees in the Division for International Treaties and Agreements shall be three (3).</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 44</b> <b>Department of General Services</b></p> <p>1. Mission of the Department of General Services shall be to provide employees in MFAD and DCM with the physical working conditions, necessary equipment and support services for the performance of their duties, and ensure proper administration of internal documents of</p>	<p>i sprovođenjem bilateralnih ili multilateralnih sporazuma;</p> <p>1.3. Održava bazu podataka sa informacijama u vezi sa međunarodnim ugovorima i sporazumima;</p> <p>1.4. Održava original potpisanog teksta, ugovora i međunarodnih sporazuma zaključenih u ime države i vlade Republike Kosovo sa nadležnim organima.</p> <p>2. Rukovodilac Odseka za međunarodne ugovore i sporazume odgovara direktoru Odeljenja za pravne poslove i ugovore.</p> <p>3. Broj zaposlenih u Odseku za međunarodne ugovore i sporazume je tri (3).</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 44</b> <b>Odeljenje za opšte usluge</b></p> <p>1. Misija Odeljenja za opšte usluge je da zaposlenima u MIPD-u i DKM-ima obezbedi fizičke uslove za rad, neophodnu opremu i usluge podrške za obavljanje njihovih poslova, kao i da obezbedi pravilno vođenje internih dokumenata MIPD-a. Odeljenje podržava odeljenja kroz</p>
---	---	--

<p>Departamenti i mbështet departamentet përmes ofrimit të shërbimeve të TI-së, mirëmbajtjes, logjistikës, administrimit të dokumenteve dhe shërbimet e tjera të ngjashme.</p> <p>2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Departamentit për Shërbime të Përgjithshme:</p> <p>2.1. Ofron shërbime dhe mbështetje administrative dhe logjistike për Ministrinë, si mirëmbajtja dhe pastrimi i hapësirave i objekteve të MPJD-së, menaxhimi i njësisë së transportit, menaxhimi dhe mirëmbajtja e inventarit në depo etj.</p> <p>2.2. Mirëmban pajisjet e TI-së dhe ofron shërbime të TI-së;</p> <p>2.3. Siguron zbatimin e procedurave për menaxhimin e të gjitha automjeteve që disponon MPJD-ja në përputhje me legjislacionin në fuqi, bën koordinimin me institucionet përkatëse për raportimin lidhur me gjendjen e automjeteve (servisim, mirëmbajtje, shpenzime të derivateve etj.) në MPJD;</p> <p>2.4. Menaxhon sistemin e arkivit dhe dokumentet e brendshme, hyrëse dhe dalëse, të MPJD-së;</p> <p>2.5. Ofron shërbime të përgjithshme të</p>	<p>MFAD. The Department shall support other Departments by providing IT services, maintenance, logistics, document administration and other similar services.</p> <p>2. Duties and responsibilities of the Department of General Services shall be as follows:</p> <p>2.1. Provide services and administrative and logistical support to the Ministry, such as maintenance and cleaning of premises of MFAD facilities, management of the transport unit, management and maintenance of inventory in warehouses, etc.;</p> <p>2.2. Maintain IT equipment and provide IT services;</p> <p>2.3. Ensure implementation of procedures for the management of all vehicles available to the MFAD, in accordance with applicable law, coordinate with relevant institutions for reporting on the condition of vehicles (servicing, maintenance, fuel costs, etc.) in the MFAD;</p> <p>2.4. Manage the archive system and MFAD's internal incoming and outgoing documents;</p> <p>2.5. Provide general services of</p>	<p>pružanje IT usluga, održavanja, logistike, upravljanja dokumentima i drugih sličnih usluga.</p> <p>2. Dužnosti i odgovornosti Odeljenja za opšte usluge:</p> <p>2.1. Pruža usluge i administrativnu i logističku podršku Ministarstvu, kao što su održavanje i čišćenje prostorija objekata MIPD-a, upravljanje transportnom jedinicom, upravljanje i održavanje inventara u skladištu i itd;</p> <p>2.2. Održava IT opremu i pruža IT usluge;</p> <p>2.3. Obezbeđuje sprovođenje postupaka za upravljanje svim vozilima na raspolaganju MIPD-a u skladu sa važećim zakonom, vrši koordinaciju sa relevantnim institucijama za izveštavanje o stanju vozila (servisiranje, održavanje, troškovi goriva itd.) u MIPD-u;</p> <p>2.4. Upravlja ulaznim i izlaznim arhivskim sistemom i internim dokumentima MIPD-a;</p> <p>2.5. Pruža opšte usluge prevođenja,</p>
---	--	--

<p>përkthimit, lekturimit dhe shpërndarjes së dokumenteve për ministrinë dhe institucionet përkatëse;</p> <p>2.6. Koordinohet me policinë për çështjen e sigurisë së objekteve.</p> <p>3. Drejtori i Departamentit për Shërbime të Përgjithshme raporton te Sekretari i Përgjithshëm.</p> <p>4. Në kuadër të këtij departamenti bëjnë pjesë këto divizione:</p> <p>4.1. Divizioni për Teknologji Informative;</p> <p>4.2. Divizioni për Logjistikë dhe Shërbime;</p> <p>4.3. Divizioni për Administrim të Dokumenteve dhe Arkiva.</p> <p>5. Numri i të punësuarve në Departamentin për Shërbime të Përgjithshme është njëzet e shtatë (27).</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 45</b> <b>Divizioni për Teknologji Informative</b></p> <p>1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Teknologji Informative:</p>	<p>translation, proofreading and distribution of documents to the relevant Ministry and institutions;</p> <p>2.6. Coordinate with the police on the issue of facility security.</p> <p>3. Director of the Department of General Services shall report to the Secretary General.</p> <p>4. The following Divisions shall be part of this Department:</p> <p>4.1. Division for Information Technology;</p> <p>4.2. Division for Logistics and Services;</p> <p>4.3. Division for Document and Archive Administration.</p> <p>5. Number of employees in the Department of General Services shall be twenty-seven (27).</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 45</b> <b>Division for Information Technology</b></p> <p>1. Duties and responsibilities of the Division for Information Technology shall be as follows:</p>	<p>lekture i distribucije dokumenata nadležnim ministarstvima i institucijama;</p> <p>2.6. Koordinira se sa policijom po pitanju bezbednosti objekata.</p> <p>3. Direktor Odeljenja za opšte usluge odgovara generalnom sekretaru.</p> <p>4. U okviru ovog Odeljenja nalaze se sledeći odseci:</p> <p>4.1. Odsek za informacionu tehnologiju;</p> <p>4.2. Odsek za logistiku i usluge;</p> <p>4.3. Odsek za administraciju dokumenata i arhiva.</p> <p>5. Broj zaposlenih u Odeljenju za opšte usluge je dvadeset sedam (27).</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 45</b> <b>Odsek za informacionu tehnologiju</b></p> <p>1. Dužnosti i odgovornosti Odseka za informacionu tehnologiju:</p>
--	---	--

<p>1.1. Siguron që shërbimet e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit të jenë efikase dhe efektive;</p> <p>1.2. Harton projekte të teknologjisë informative në interes të MPJD -së;</p> <p>1.3. Ofron mbështetje të TI-së për stafin e MPJD -së;</p> <p>1.4. Siguron ofrimin e shërbimeve cilësore të pajisjeve për TI;</p> <p>1.5. Siguron mirëmbajtjen e duhur të të gjitha pajisjeve të TI-ve (duke përfshirë kompjuterët dhe pajisjet përcjellëse, pajisjet për fotokopjim, telefona, fax, serverët, sistemin e Access kontrollit etj.);</p> <p>1.6. Siguron funksionimin normal dhe të rregullt të sistemit të telefonisë VoIP dhe funksionimin e rrjetit;</p> <p>1.7. Mban seanca të trajnimit me personelin e ri sipas kërkesës (lidhur me kompjuterët, internetin, bazat e të dhënave që i posedon MPJD-ja etj.);</p> <p>1.8. Siguron bashkëpunim të mirëfilltë mes Divizionit të TI-së dhe ASHI-së;</p> <p>1.9. Zbaton standardet ndërkombëtare të Teknologjisë Informative, legjislacionin</p>	<p>1.1. Ensure that information and communication technology services are efficient and effective;</p> <p>1.2. Draft information technology projects in the interest of MFAD;</p> <p>1.3. Provide IT support to MFAD’s staff;</p> <p>1.4. Provide quality services of IT equipment;</p> <p>1.5. Ensure proper maintenance of all IT equipment (including computers and ancillary equipment, photocopiers, telephones, fax machines, servers, access control system, etc.);</p> <p>1.6. Ensure normal and regular operation of VoIP telephone system and network operation;</p> <p>1.7. Holds training sessions with new staff upon request (regarding computers, internet, databases owned by MFAD, etc.);</p> <p>1.8. Ensure genuine cooperation between the Division of IT and AIS;</p> <p>1.9. Implement international standards of Information Technology, legislation and</p>	<p>1.1. Obezbeđuje da su usluge informacione i komunikacione tehnologije efikasne i efektivne;</p> <p>1.2. Izrađuje projekte informacionih tehnologija u interesu MIPD-a;</p> <p>1.3. Obezbeđuje IT podršku osoblju MIPD-a;</p> <p>1.4. Obezbeđuje pružanje kvalitetnih usluga opreme za IT;</p> <p>1.5. Obezbeđuje pravilno održavanje sve IT opreme (uključujući računare i prateću opremu, uređaja za fotokopiranje, telefona, faks mašine, servera, sistema kontrole pristupa itd.);</p> <p>1.6. Obezbeđuje normalan i uredan rad sistema VoIP telefonije i rad mreže;</p> <p>1.7. Održava obuke sa novim osobljem na zahtev (u vezi sa računarima, internetom, bazama podataka u vlasništvu MIPD-a itd.);</p> <p>1.8. Obezbeđuje pravilnu saradnju između Odseka za IT i AID-a;</p> <p>1.9. Sprovodi međunarodne standarde informacione tehnologije,</p>
---	--	---

<p>dhe monitoron dispozitat e shërbimit të TI-ve në MPJD.</p> <p>2. Udhëheqësi i Divizionit për Teknologji Informative raporton te drejtori i Departamentit për Shërbime të Përgjithshme.</p> <p>3. Numri i të punësuarve në Divizionin për Teknologji Informative është pesë (5).</p>	<p>monitor provisions of the IT service in MFAD.</p> <p>2. Head of the Division for Information Technology shall report to the Director of the Department of General Services.</p> <p>3. The number of employees in the Division for Information Technology shall be five (5).</p>	<p>zakonodavstvo i prati pružanje IT usluge u MIPD-u.</p> <p>2. Rukovodilac Odseka za informacionu tehnologiju odgovara direktoru Odeljenja za opšte usluge.</p> <p>3. Broj zaposlenih u Odseku za informacionu tehnologiju je pet (5).</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 46</b> <b>Divizioni për Logjistikë dhe Shërbime</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 46</b> <b>Division for Logistics and Services</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 46</b> <b>Odsek za logistiku i usluge</b></p>
<p>1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Logjistikë dhe Shërbime:</p> <p>1.1. Menaxhon të gjitha automjetet që disponon MPJD-ja, mirëmbajtjen dhe servisimin e tyre;</p> <p>1.2. Ndërmerr kontroll periodik dhe ditor, me qëllim të verifikimit të zbatimit të legjislacionit për përdorimin e automjeteve;</p> <p>1.3. Menaxhon nevojat e transportit dhe automjetet e ministrisë;</p> <p>1.4. Mirëmban evidencën e regjistrimit dhe sigurimit të automjeteve, si dhe të gjitha çështjet e tjera të logjistikës;</p>	<p>1. Duties and responsibilities of the Division for Logistics and Services shall be as follows:</p> <p>1.1. Manage all vehicles available to the MFAD, their maintenance and servicing;</p> <p>1.2. Undertake periodic and daily control, in order to verify the implementation of legislation on the use of vehicles;</p> <p>1.3. Manage transport needs and vehicles of the Ministry;</p> <p>1.4. Maintain records of vehicle registration and insurance, and all other logistics issues;</p>	<p>1. Dužnosti i odgovornosti Odseka za logistiku i usluge:</p> <p>1.1. Upravlja svim vozilima na raspolaganju MIPD-a, njihovim održavanjem i servisiranjem;</p> <p>1.2. Vršiti periodičnu i dnevnu kontrolu, u cilju provere sprovođenja propisa o upotrebi vozila;</p> <p>1.3. Upravlja transportnim potrebama i vozilima ministarstva;</p> <p>1.4. Vodi evidenciju registracije vozila i osiguranja, kao i sva ostala logistička pitanja;</p>

<p>1.5. Organizon transportimin e delegacioneve zyrtare gjatë vizitave në Republikën e Kosovës;</p> <p>1.6. Menaxhon inventarin dhe depot e Ministrisë;</p> <p>1.7. Koordinon kërkesat dhe nevojat e Ministrisë për mallra dhe pajisje të zyrës për punë;</p> <p>1.8. Ofron ndihmë logjistike për personelin e Ministrisë;</p> <p>1.9. Menaxhon recepcionin e Ministrisë;</p> <p>1.10. Siguron përkthim në mënyrë profesionale nga gjuha shqipe në gjuhën serbe dhe anasjelltas, dhe nga të dyja këto gjuhë në gjuhën angleze dhe anasjelltas, në varësi të kërkesave të Ministrisë;</p> <p>1.11. Siguron korrigjime të cilësisë së lartë të përkthimeve, përditëson bazën e të dhënave të të gjitha materialeve të përkthyer, si dhe i ruan ato materiale.</p> <p>2. Udhëheqësi i Divizionit për Logjistikë dhe Shërbime raporton te drejtori i Departamentit për Shërbime të Përgjithshme.</p> <p>3. Numri i të punësuarve në Divizionin për</p>	<p>1.5. Organize transportation of official delegations during visits to the Republic of Kosovo;</p> <p>1.6. Manage inventory and warehouses of the Ministry;</p> <p>1.7. Coordinate requests and needs of the Ministry for goods and equipment of the labour office;</p> <p>1.8. Provide logistical assistance to Ministry's staff;</p> <p>1.9. Manages the reception of the Ministry;</p> <p>1.10. Provide professional translation from Albanian to Serbian and vice versa, and from both of these languages into English and vice versa, depending on requests of the Ministry;</p> <p>1.11. Provide high quality translations corrections, update the database of all translated materials, and preserve those materials.</p> <p>2. Head of the Division for Logistics and Services shall report to the Director of the Department of General Services.</p> <p>3. Number of employees in the Division for</p>	<p>1.5. Organizuje prevoz zvaničnih delegacija tokom poseta Republici Kosovo;</p> <p>1.6. Upravlja inventarom i skladištima Ministarstva;</p> <p>1.7. Koordinira zahteve i potrebe Ministarstva za kancelarijskom radnom robom i opremom;</p> <p>1.8. Pruža logističku pomoć osoblju Ministarstva;</p> <p>1.9. Rukovodi prijemom Ministarstva;</p> <p>1.10. Obezbeđuje stručni prevod sa albanskog na srpski i obrnuto, i sa oba ova jezika na engleski i obrnuto, u zavisnosti od zahteva Ministarstva;</p> <p>1.11. Obezbeđuje kvalitetne ispravke prevoda, ažurira bazu podataka svih prevedenih materijala, kao i čuva te materijale.</p> <p>2. Rukovodilac Odseka za logistiku i usluge odgovara direktoru Odeljenja za opšte usluge.</p> <p>3. Broj zaposlenih u Odseku za logistiku i</p>
--	--	--

<p>Logjistikë dhe Shërbime është shtatëmbëdhjetë (17).</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 47</b> <b>Divizioni për Administrim të Dokumenteve dhe Arkiv</b></p> <p>1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Administrim të Dokumenteve dhe Arkiv:</p> <p>1.1. Mirëmban dhe administron sistemin e arkivit të MPJD-së;</p> <p>1.2. Mirëmban dhe administron, të gjitha shkresat hyrëse dhe dalëse të MPJD-së, duke përfshirë shkresat diplomatike, notat verbale, notat e njohjeve të RKS-së, kredencialet, AGREMENTE, marrëveshjet ndërkombëtare, memorandume të ndryshme mirëkuptimi etj.;</p> <p>1.3. Siguron që njësitë arkivore të jenë të shënuara me shenjat e përcaktuara sipas rregullave;</p> <p>1.4. Përkujdeset për afatet e arkivimit të lëndëve, si dhe përgatit lëndët me afat të përhershëm për dorëzim në Arkivin e Republikës të Kosovë, sipas dispozitave ligjore;</p> <p>1.5. Klasifikimin e lëndëve sipas kriterëve të klasifikimit të informacionit (top sekret, sekret, konfidenciale);</p>	<p>Logistics and Services shall be seventeen (17).</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 47</b> <b>Division for Document and Archive Administration</b></p> <p>1. Duties and responsibilities of the Division for Document and Archive Administration shall be as follows:</p> <p>1.1. Maintain and administer MFAD's archive system;</p> <p>1.2. Maintain and administer all incoming and outgoing letters of the MFAD, including diplomatic letters, verbal notes, recognition notes of RKS, credentials, agreements, international agreements, various memorandum of understanding, etc.;</p> <p>1.3. Ensure that archival units are marked with the signs defined according to rules;</p> <p>1.4. Take care of deadlines for archiving cases, and prepare cases with a permanent deadline for submission to the Archive of the Republic of Kosovo, according to legal provisions;</p> <p>1.5. Classify cases according to criteria of information classification (top secret, secret, confidential);</p>	<p>usluge je sedamnaest (17).</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 47</b> <b>Odsek za administraciju dokumenata i arhiva</b></p> <p>1. Dužnosti i odgovornosti Odseka za administraciju dokumenata i arhiva:</p> <p>1.1. Održava i upravlja arhivskim sistemom MIPD-a;</p> <p>1.2. Održava i upravlja svim ulaznim i izlaznim dokumentima MIPD-a, uključujući diplomatska pisma, verbalne note, note o priznanjima RKS-a, akreditive, agremane, međunarodne sporazume, razne memorandume o razumevanju itd.;</p> <p>1.3. Obezbeđuje da su arhivske jedinice označene oznakama definisanim u skladu sa pravilima;</p> <p>1.4. Stara se o rokovima za arhiviranje predmeta, kao i priprema predmete sa trajnim rokom za predaju Arhivu Republike Kosovo, u skladu sa zakonskim odredbama;</p> <p>1.5. Klasifikacija predmeta prema kriterijumima klasifikacije informacija (strogo poverljivo, tajno, poverljivo);</p>
---	--	--

<p>1.6. Monitoron sistemin e arkivit, sistematizimin e lëndëve arkivore, afatizimin dhe asgjësimit e lëndëve arkivore sipas afateve ligjore në misionet diplomatike dhe konsullore;</p> <p>1.7. Menaxhon të gjitha dokumentet e klasifikuara që prodhohen në MPJD dhe ato që dërgohen nga jashtë, si dhe bën administrimin e punës në zyrë dhe të dokumenteve zyrtare, që nga evidencimi fillestar deri në procedimin përfundimtar të tyre;</p> <p>1.8. Zbaton afatet e përcaktuara për shfrytëzim, qarkullim dhe ruajtjen e informacionit të klasifikuar;</p> <p>1.9. Punon në bazë të librave të veçantë që përcaktohen nga autoriteti kompetent për evidentim dhe qarkullim të dokumenteve;</p> <p>1.10. Ruan dokumentacionin në kasaforta të veçanta sipas standardeve të përcaktuara;</p> <p>1.11. Sistemon dhe inventarizon informacionin e klasifikuar, para dorëzimit në Arkivin e MPJD-së.</p> <p>2. Udhëheqësi i Divizionit për Administrim të Dokumenteve dhe Arkiv raporton te drejtori i Departamentit për Shërbime të</p>	<p>1.6. Monitor the archive system, systematization of archival materials, timeliness and destruction of archival materials, according to legal deadlines in diplomatic and consular missions;</p> <p>1.7. Manage all classified documents produced in MFAD and those that are sent from abroad, as well as administer office work and official documents, from the initial evidence to their final processing;</p> <p>1.8. Implement deadlines set for the use, circulation and storage of classified information;</p> <p>1.9. Work on the basis of special books determined by the competent authority for evidencing and circulation of documents;</p> <p>1.10. Store documentation in special safes according to defined standards;</p> <p>1.11. Systematize and inventory the classified information, before submission to the MFAD Archive.</p> <p>2. Head of the Division for Document and Archive Administration shall report to the Director of the Department of General</p>	<p>1.6. Prati arhivski sistem, sistematizaciju arhivske građe, oročenje i uništavanje arhivske građe prema zakonskim rokovima u diplomatskim i konzularnim misijama;</p> <p>1.7. Upravlja svim poverljivim dokumentima koji se izrađuju u MIPD-a i onima koji se šalju iz inostranstva, kao i upravlja kancelarijskim radom i službenim dokumentima, od početnog evidentiranja do njihove konačne obrade;</p> <p>1.8. Sprovodi propisane rokove za korišćenje, promet i čuvanje tajnih podataka;</p> <p>1.9. Radi na osnovu posebnih knjiga koje određuje nadležni organ za evidentiranje i promet dokumenata;</p> <p>1.10. Čuva dokumentaciju u posebnim sefovima prema definisanim standardima;</p> <p>1.11. Sistematizuje i inventariše tajne podatke, pre dostavljanja u Arhivu MIPD-a.</p> <p>2. Rukovodilac Odseka za administraciju dokumenata i arhiva odgovara direktoru Odeljenja za opšte usluge.</p>
---	--	--



<p>Përgjithshme.</p> <p>3. Numri i të punësuarve në Divizionin për Administrim të Dokumenteve dhe Arkiv është tre (3).</p> <p style="text-align: center;"><b>Neni 48</b> <b>Departamenti për Çështje Konsullore</b></p> <p>1. Departamenti për Çështje Konsullore ka për mision ofrimin e shërbimeve konsullore, hartimin e politikave konsullore dhe zhvillimin e mbikëqyrjen e procedurave të lëshimit të vizave nga misionet diplomatike dhe konsullore (MDK).</p> <p>2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Departamentit për Çështje Konsullore:</p> <p>2.1. Propozon, harton dhe siguron zbatimin e dokumenteve të politikave/strategjive dhe legjislacionit në fushën konsullore për misionet diplomatike dhe konsullore të Republikës së Kosovës;</p> <p>2.2. Bashkërendon aktivitetet konsullore me misionet diplomatike dhe konsullore të Republikës së Kosovës jashtë vendit;</p> <p>2.3. Ofron shërbime konsullore për shtetasit e Republikës së Kosovës dhe për shtetasit e huaj që dëshirojnë të hyjnë në Kosovë.</p>	<p>Services.</p> <p>3. The number of employees in the Division for Document and Archive Administration shall be three (3).</p> <p style="text-align: center;"><b>Article 48</b> <b>Department of Consular Affairs</b></p> <p>1. The mission of the Department of Consular Affairs shall be to provide consular services, draft consular policies, and develop and oversee visa issuance procedures by diplomatic and consular missions (DCMs).</p> <p>2. Duties and responsibilities of the Department of Consular Affairs shall be as follows:</p> <p>2.1. Propose, draft and ensure the implementation of policy documents/strategies and legislation in the consular field for diplomatic and consular missions of the Republic of Kosovo;</p> <p>2.2. Coordinate consular activities with diplomatic and consular missions of the Republic of Kosovo abroad;</p> <p>2.3. Provide consular services to citizens of the Republic of Kosovo and to foreign citizens wanting to enter Kosovo.</p>	<p>3. Broj zaposlenih u Odseku za administraciju dokumenata i arhiva je tri (3).</p> <p style="text-align: center;"><b>Član 48</b> <b>Odeljenje za konzularne poslove</b></p> <p>1. Misija Odeljenja za konzularne poslove je da pruža konzularne usluge, izrađuje nacрте konzularnih politika i razvija i nadgleda procedure izdavanja viza od strane diplomatskih i konzularnih misija (DKM).</p> <p>2. Dužnosti i odgovornosti Odeljenja za konzularne poslove:</p> <p>2.1. Predlaže, izrađuje i obezbeđuje sprovođenje političkih dokumenata/strategija i zakonodavstva u konzularnoj oblasti za diplomatske i konzularne misije Republike Kosovo;</p> <p>2.2. Koordinira konzularne aktivnosti sa diplomatskim i konzularnim misijama Republike Kosovo u inostranstvu;</p> <p>2.3. Pruža konzularne usluge za državljane Republike Kosovo i za strane državljane koji žele da uđu na Kosovo.</p>
---	---	---

<p>3. Udhëheqësi i Departamentit për Çështje Konsullore raporton te Sekretari i Përgjithshëm.</p> <p>4. Në kuadër të Departamentit për Çështje Konsullore bëjnë pjesë këto divizione:</p> <p>4.1. Divizioni për Shërbime Konsullore;</p> <p>4.2. Divizioni për Politika Konsullore;</p> <p>4.3. Divizioni i Vizave.</p> <p>5. Numri i të punësuarve në Departamentin për Çështje Konsullore është shtatëmbëdhjetë (17).</p>	<p>3. The Head of the Department of Consular Affairs shall report to the Secretary General.</p> <p>4. The following Divisions shall be part of the Department of Consular Affairs:</p> <p>4.1. Division for Consular Services;</p> <p>4.2. Division for Consular Policy;</p> <p>4.3. Division for Visa.</p> <p>5. The number of employees in the Department of Consular Affairs shall be seventeen (17).</p>	<p>3. Rukovodilac Odeljenja za konzularne poslove odgovara generalnom sekretaru.</p> <p>4. U okviru ovog Odeljenja za konzularne poslove nalaze se sledeći odseci:</p> <p>4.1. Odsek za konzularne usluge;</p> <p>4.2. Odsek za konzularnu politiku;</p> <p>4.3. Odsek za vize.</p> <p>5. Broj zaposlenih u Odeljenju za konzularne poslove je sedamnaest (17).</p>
